

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	VIDEO/ Rritja e çmimit të karburantit ndez protestat në Portugali, 500 kamionë dalin në rrugë - Informoh u siç duhet
ADRESA	https://radar.al/video-rritja-e-cmimit-te-karburantit-ndez-protestat-ne-portugali-500-kamione-dalin-ne-rruge/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 16:26:28 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 16:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e9f10eab3567d66e1c82e549537cf9d8ab92600f36a7df759cc66bf65e704699
TEKSTI	e40b51a659e319b15771e1d99032cb4a889287e55c757552a66165d7017171db
PAMJA	1882b4fa6e2ed9409ca7aec921fee0cf2047d3891a8c09924228c55ed1cfb0d3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a6a92bbdb7c9433961b448b740601d298fef0631a019de99e629de07d0929e83
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	77d68db3023b2e51e8611bf6d5eddb24bf36cfc38da7912fff4d1353a313a25f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a6a92bbdb7c9433961b448b740601d298fef0631a019de99e629de07d0929e83>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: [Home](#) » [VIDEO/ Rritja e çmimit të karburantit ndez protestat në Portugali, 500 kamionë dalin në rrugë](#)

BOTË

Demo

VIDEO/ Rritja e çmimit të karburantit ndez protestat në Portugali, 500 kamionë dalin në rrugë

SEPTEMBER 25, 2026



Rritja e çmimeve të karburanteve ka nxitur protesta në Portugali, ku rreth 500 kamionë kanë dalë në rrugë në veri të vendit, ndërsa në Lisbonë drejtuesit e mjeteve kanë protestuar duke përdorur boritë e automjeteve.

Marshimi i kamionëve nisi në orët e para të mëngjesit në një zonë industriale në periferi të Portos. Kamionët i përkasin kompanive të ndërtimit që nuk përfitojnë nga subvencionet e qeverisë për sektorin e transportit dhe u nisën në drejtim të Coimbrës.

Konvoji ka përshkuar autostradën që lidh veriun me jugun e Portugalisë dhe pritet të përshkojë rreth 140 kilometra. Në nisje, kamionët kanë lëvizur me shpejtësi të reduktuar në korsinë e djathtë, pa bllokuar plotësisht qarkullimin e automjeteve të tjera.

Protestuesit kërkojnë uljen e taksave mbi karburantet, si dhe pezullimin e disa tarifave dhe masave që lidhen me punën në distancë. Ata shprehen se rritja e vazhdueshme e kostove po e vështirëson ndjeshëm aktivitetin e tyre ekonomik.

Ndërkohë, në Lisbonë, drejtuesit e mjeteve kanë organizuar një protestë me boritë e automjeteve në një nga urat mbi lumin Tagus, në shenjë kundërshtimi ndaj çmimeve të larta të karburanteve.

Çmimet e karburanteve në Portugali kanë arritur nivele rekord gjatë kësaj jave. Sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Energjisë, çmimi mesatar i naftës ka kaluar 2.22 euro për litër, ndërsa benzina ka arritur në rreth 2.11 euro për litër.

Përballë rritjes së çmimeve, qeveria portugeze ka ndërmarrë disa masa për të kufizuar ndikimin e tyre. Që prej marsit janë ulur taksat mbi karburantet, ndërsa janë parashikuar edhe mekanizma për ndërhyrje në rast të krizave energjetike.

[kamionë](#) [karburantit](#) [Portugali](#)

SHARE.



Postimet e reja

**Rama në New York:
Aeroporti i Tiranës,...**

SEPTEMBER 25, 2026

**VIDEO/ Rritja e çmimit të
karburantit ndez...**

SEPTEMBER 25, 2026

**Trump pret sërish Xi
Jinping në Shtëpinë e...**

SEPTEMBER 25, 2026

**FOTO/ Ivanka Trump
mahnit në darkën...**

SEPTEMBER 25, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 24, 2026

**Dosja/ Biznesmeni Meqemeja i dha
Ahmetajt 140 mijë euro! SPAK:
Shpërblim për Inceneratorin e
Fierit përmes shitjeve fiktive**

Biznesmeni Sokol Meqemeja njihet si pronar i disa kompanive apo sipërmarrjeve. Përveç "Delvina Gas" ai...

**ALERT në Slloveni për VIPA
Flips të Kosovës, kanë
përmbytje të alergjenësh.
Produkti hiqet nga tregu**

**Kreditorët te dera, gjykata
në kërkim të "Top Fruits"
të Ejup Ahmetit dhe Marin
Gjonajt: Paraqituni në gjyq**

**Kompania e krijuar tri ditë
pas hapjes së thirrjes për
grantet e startupeve fitoi
6.1 milionë lekë në fazën e
rezervuar për biznese të
paktën 1-vjeçare**

Na ndiq

[Facebook](#)[Instagram](#)[YouTube](#)[TikTok](#)

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Horoskopi/ Parashikimi i yjeve për ditën e sotme, 24 Shtator 2026

Njohje të reja për beqarët, mundësi fitimi dhe sfida në punë, çfarë thonë yjet për ju sot

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

[raporto këtu](#)

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.